



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

**MENDIM I AVOKATIT TË POPULLIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS NË
CILËSINË E MIKUT TË GJYKATËS (AMICUS CURIAE)**

drejtuar

Gjykatës Themelore në Prishtinë

lidhur me

procesin gjyqësor A.nr.1843/2022 të iniciuar nga z. Lavdim Krasniqi

R.nr. 70/2025

Drejtuar: Ngadhnjim Arni, kryetar
Gjykata Themelore në Prishtinë

Prishtinë, më 9 qershor 2026

Qëllimi

Ky Mendim Juridik në cilësinë e mikut të gjykatës ka për qëllim të paraqesë qëndrimin e Avokatit të Popullit nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut dhe në këtë kuadër të ofrojë një analizë ligjore lidhur me respektimin e parimit të ligjshmërisë në marrëdhëniet e punës, si dhe mbrojtjen e të drejtave të tjera që burojnë nga këto marrëdhënie.

Mendimi bazohet në ankesën e parashtruar nga z. Lavdim Krasniqi (në vijim: ankuesi), lidhur me pretendimet e tij për ndërprerjen e marrëdhënies së punës nga pozita Drejtor i Sekretariatit të Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK) pa ndonjë arsyetim të bazuar në ligj.

Përmbledhja e fakteve

1. Ankuesi kishte themeluar marrëdhënie pune dhe kishte fituar statusin i nëpunësit civil të karrierës me datën 1 prill 2006 kur ishte përzgjedhur fillimisht si Koordinator i Programit dhe më pas nga data 14 dhjetor 2007 në pozitën e Drejtorit të Institutit Gjyqësor të Kosovës. Nga muaji gusht 2015 ishte transferuar në pozitën Drejtor për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë, pastaj nga data 12 shkurt 2016 ishte emëruar Drejtor i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së.
2. Më 1 mars 2021, Prokuroria Themelore në Prishtinë inicio procedurë penale ndaj ankuesit, ndërsa më 13 gusht 2021 ju ngrit aktakuzë për veprat penale që kanë të bëjnë me ushtrim ndikimi, keqpërdorim i detyrës zyrtare, keqpërdorim i detyrës zyrtare nga fusha e prokurimit dhe mos deklarim i pasurisë.
3. Ankuesi pohon se pas fillimit të procedurës penale ndaj tij, KPK përmes Vendimit KPK/Nr.57/2021, të datës 2 mars 2021, e kishte pezulluar ankuesin nga ushtrimi i detyrave zyrtare si Drejtor i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së, me pagesë prej 50% të pagës deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata kompetente. Sipas ankuesit, ky vendim nuk është shfuqizuar asnjëherë me ndonjë vendim tjetër.
4. Ankuesi pohon se përkundër faktit se ndaj tij ishte në zhvillim e sipër procedura penale, KPK-ja përmes Vendimit KPK/353/2021, të datës 28 maj 2021 themeloi Komisionin Disiplinor për zhvillimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit dhe më 24 gusht 2021, Komisioni Disiplinor mori Vendimin KPK.nr.661/2021 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës.
5. Më 7 tetor 2021, ankuesi parashtroi ankesë në KPMSHCK lidhur me Vendimin KPK/nr.661/2021 kurse më 1 dhjetor 2021, KPMSHCK-ja mori Vendimin A.nr.854/2021, përmes së cilës e aprovoi ankesën e parashtruar nga ankuesi duke shfuqizuar Vendimin KPK.nr.661/2021 të KPK-së për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me të cilin çështjen e kthen në KPK për rishqyrtim dhe rivendosje.
6. KPK pas Vendimit A.nr.854/2021, të KPMSHCK-së për rishqyrtimin dhe rivendosje nuk mori ndonjë vendim lidhur me çështjen e ankuesit. Ankesa e parashtruar me 7 tetor 2021, është riaktivizuar me kërkesë të ankuesit, me ç' rrast KPMSHCK-ja më 6 qershor 2022, mori Vendimin e dytë A.nr.854/2021, nëpërmjet së cilës e aprovoi pjesërisht ankesën e parashtruar nga ankuesi duke anuluar Vendimin KPK.nr.661/2021, dhe duke obliguar drejtorin e Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës që brenda afatit prej 15 ditësh të largoi nga dosja e ankuesit masën disiplinore ndërprerje e marrëdhënies së punës, e shqiptuar sipas vendimit të lartpërmendur.

7. Megjithatë, KMPShCK në rastin e marrjes së Vendimit A.nr. 854/2021, nuk vendosi lidhur me kërkesën e ankuesit për kthim në vend të punës por vetëm e shfuqizoi masën disiplinore për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, duke e kthyer çështjen në rivendosje dhe rishqyrtim të KPK. KPK duke mos e përfillur vendimin e KPMSHCK-së, nuk vendosi asnjëherë në procedurë të rivendosjes.
8. Më 28 prill 2022, KPK-ja në zbatim të Vendimit të KPMSHCK, A.nr.854/2021, të datës 1 dhjetor 2021 mori Vendimin Nr.604/2022 për të kompensuar ankuesin me 50% të pagës deri më 12 shkurt 2022, pas së cilës datë, KPK i ndërpreu marrëdhënien e punës dhe po ashtu edhe pagesën prej 50% të pagës, që sipas ankuesit në këto dy çështje, KPK ka shkelë dispozita ligjore në fuqi.
9. Për më tepër, ankuesi pohon se KPK ka realizuar pagesën prej 50% të pagës për dy zyrtarët e tjerë, F.D. dhe M.B., që janë pjesë e procesit të njëjtë penal, kurse nuk ishte vepruar njëjtë edhe me atë, e që sipas tij kjo qasje përbën qasje diskriminuese.
10. Më 21 korrik 2022, ankuesi pohon se parashtrori padi në GjThP, A.nr.1843/2022 për anulimin e pjesshëm të Vendimit A. nr. 854/2021, të datës 6 qershor 2022 të KPMSHCK, respektivisht ankuesi kërkoi të priset pjesa e vendimit me të cilin konsiderohet se i ka skaduar marrëdhënia e punës me skadim të kontratës dhe ka kërkuar që gjykata ta obligojë KPK-së që të bëjë pagesën e pagës për pozitën Drejtor i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së dhe të gjitha të drejtave e tjera, siç përcaktohet me ligj nga data 12 shkurt 2022.
11. Ankuesi pohon se më 7 nëntor 2022 e plotësoi padinë në aspektin objektiv, respektivisht kërkoi aplikimin e masës së sigurisë për arsye se sipas tij, KPK kishte shpallur konkurs për pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit.
12. Më 14 prill 2025, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit përmes postës elektronike kërkoi informata nga GjThP për veprime procedurale lidhur me rastin e ankuesit dhe më 16 prill 2025, pranoi përgjigje sipas të cilës gjyqtarja e çështjes lëndën e ka trashëguar në shtator të vitit 2024, pasi gjyqtari paraprak është ngritur në detyrë, dhe se lënda do të procedohet sipas radhës së pranimit/regjistrimit të lëndëve në gjykatë pasi lëndët e prioritetit të njëjtë trajtohen sipas radhës. Sipas informatave të fundit nga ankuesi, në muajin tetor 2025 është mbajtur seancë gjyqësore lidhur me rastin dhe është caktuar hartimi i ekspertizës financiare.
13. Më 26 nëntor 2025, Avokati i Popullit pranoi informata shtesë nga ankuesi në formë të plotësimit të ankesës, përfshirë edhe pretendime për diskriminim, për faktin që sipas tij në të njëjtën kohë KPK vazhdimisht ka bërë pagesën e shumës prej 50% të pagës për dy zyrtarët tjerë që ishin pjesë e të njëjtit proces penal.

Opinion i Avokatit të Popullit

14. Bazuar në pretendimet ankimore dhe analizës së rastit si dhe hetimet lidhur me shkeljen e të drejtave të njeriut, Avokati i Popullit konsideron si të padrejtë veprimin e KPK për ndërprerjen e pagesë prej 50% të pagës deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata kompetente, pasi që kjo është në kundërshtim me vendimin KPK/Nr.57/2021, të datës 2 mars 2021, i cili nuk është shfuqizuar asnjëherë me ndonjë vendim tjetër.
15. Rrjedhimisht, Avokati i Popullit e konsideron si të rëndësishme që gjykata gjatë shqyrtimit të rastit të vlerësojë me rastin e vendosjes së kësaj çështjeje, të ketë parasysh

çështjen e mos pagesës së 50% të pagës, të vendosur tashmë përmes Vendimit të KPMSHCK, në pajtim me Ligjin nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, neni 71, par.7, i cili përcakton se *“Nëpunësja/i civil gjatë periudhës së pezullimit nuk përfiton pagë, me përjashtim në rastin e përcaktuar në paragrafin 1, nën-paragrafët 1.1. dhe 1.10. të nenit 69 të këtij ligji, nëpunësja/i civil përfiton pesëdhjetë për qind (50 %) të pagës së plotë, duke përjashtuar çdo lloj shtesë në pagë, për një periudhë pezullimi deri në gjashtë (6) muaj”*, njëjtë sikurse për dy zyrtarët e tjerë, F.D. dhe M.B., që janë pjesë e procesit të njëjtë penal, që sipas pretendimeve të ankuesit, të njëjtëve vazhdimisht KPK u kishte bërë këtë lloj pagese.

16. Po ashtu, Avokati i Popullit vlerëson se në rastin e ankuesit, KPK ka kryer veprime kontradiktore për faktin që pas Vendimit të KPMSHCK, A.nr.854/2021, të datës 6 qershor 2022, KPK mori vendim për të kompensuar ankuesin me 50% të pagës në mënyrë retroaktive nga data 24 gusht 2021 deri më 12 shkurt 2022, e në anën tjetër përcakton që kompensimi të bëhet *“siç parashihet me Vendimin KPK.Nr.57/2021, të datës 2 mars 2021”*, mirëpo në atë vendim ishte përcaktuar që ankuesi të kompensohet me 50% të pagës *“deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata”*. Një rregull e tillë e kompensimit është e përcaktuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Kosovës, neni 69 i Ligjit Nr./03/L-149, i cili ishte në fuqi në kohën e vendimeve të KPK dhe KPMSHCK si dhe Ligjit për Zyrtarët Publik tani në fuqi, neni 69, par.1, nënpar.1.5 i lidhur me nenin 71, par.8 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, që përcakton se nëpunësi i pezulluar merr 50% të pagës deri në vendimin përfundimtar nga gjykata.
17. Po ashtu, Avokati i Popullit vlerëson se në këtë rast nuk është respektuar neni 90 i Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës në kohën kur KPK dhe KPMSHCK e konsideruan të përfunduar marrëdhënien e punës së ankuesit, edhe pse e njëjta si pozitë pune e nëpunësit civil të karrierës nuk përfundonte me skadimin e mandatit për nëpunësin civil të nivelit të lartë drejtues, respektivisht nëse përfundonte mandati në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit, kjo nuk nënkuptonte edhe ndërprerjen e marrëdhënies së punës, pra përfundimin e statusit të nëpunësit civil të karrierës në shërbimin civil të Kosovës, edhe pse ndaj ankuesit ishte në zbatim masa e pezullimit.
18. Neni 90 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përcaktonte se:
1. *Marrëdhënia e punës e nëpunësit civil përfundon me krijimin e kushteve dhe fakteve, pavarësisht nga dëshira e nëpunësit civil ose institucioni.*
 2. *Marrëdhënia e punës në shërbimin civil përfundon me:*
 - 2.1. *arritjen e moshës së pensionimit;*
 - 2.2. *paafësinë e përhershme për ushtrimin e detyrës zyrtare për arsye shëndetësore;*
 - 2.3. *përfundimin e afatit për punësimet me afat të caktuar sipas këtij ligji;*
 - 2.4. *dënimin nga një gjykatë penale me vendim të formës së prerë për mbajtjen e burgut efektiv për gjashtë (6) muaj e më tepër;*
 - 2.5. *vdekjen e nëpunësit civil.*

19. Avokati i Popullit vlerëson se në veprime e KPK kishte shkelje të parimit të prezumimit të pafajësisë, përfundimi i marrëdhënies së punës për një nëpunës civil përveç tjerash mund të bëhet nëse ai/ajo dënohet me vendim përfundimtar të gjykatës e që në rastin e ankuesit, bazuar në pretendimet dhe dokumentacionin e dorëzuar në Institucion e Avokatit të Popullit një vendim i tillë nuk ekziston.
20. Avokati i Popullit rithekson të nevojshme veprime efektive dhe veprime brenda një afati të arsyeshëm kohor për vendosjen meritore në çështjen e ankuesit sipas padisë së parashtruar më 21 korrik 2022, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe nenin 6, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj.

Me nderime,

Naim Qelaj
Avokat i Popullit

